





LISTA E NËNSHKRIMEVE

Mekanizmi Komunal Kundër Dhunës në Familje, Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Bazë Gjinore

Data: 20.04.2026 (henë)

Ora: 10:30

Vendi: Salla e takimeve KPF-së, Kati 3, Komuna e Pejës

Nr.	Emri dhe mbiemri	Institucioni/OJQ/Shoqeria civile	Nënshkrimi
1.	SHPRESA LUKAS	Q.P.S	<i>[Signature]</i>
2.	DURIM KALMENDI	Q.P.S	<i>[Signature]</i>
3.	BLERIM SHANA	ANJF	<i>[Signature]</i>
4.	Dr. Fati Halilaj	SHSK	<i>[Signature]</i>
5.	BESIANA LUKA	ZP - PEJE	<i>[Signature]</i>
6.	EDISON BERDYNA	QAP - PEJE	<i>[Signature]</i>
7.	Bexarta Breznica	RrGK	<i>[Signature]</i>
8.	Alisa Gjeza	DKA - Peje	<i>[Signature]</i>
9.	Tringa Dresha	OSCE	<i>[Signature]</i>
10.	Arbata Balu	ONG	<i>[Signature]</i>
11.	Arbëresha Turfy	SE. POLICOR - Peje	<i>[Signature]</i>
12.	Donis Hashani	P. SH. ZMURR/POTO	<i>[Signature]</i>
13.	D. LUKASO PEJA	Dr. Fati Halilaj	<i>[Signature]</i>
14.	SAMKA DRANÇOLLI	KOMUNA PEJE	<i>[Signature]</i>
15.			
16.			
17.			
18.			
19.			
20.			
21.			



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS * MUNICIPALITY OF PEJA * OPŠTINA PEĆ

Datë: 20.04.2026

KOMUNA E PEJËS Zyra për Barazi Gjinore
Mekanizmi Koordinues Lokal kundër Dhunës në Familje, Dhunës ndaj Gruas dhe
Dhunës në Bazë Gjinore

PROCESVERBAL

I takimit të parë të Mekanizmit Lokal Kundër Dhunës në Familje për vitin 2026

Data: 20 Prill 2026 (E hënë)

Ora: 10:30 – 12:15

Vendi: Salla e takimeve të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF), Kati 3, Komuna e Pejës

Kryesuese: Samka Drançolli – Zyrtarja për Barazi Gjinore / Koordinatore e Mekanizmit

Rendi i ditës:

1. Raporti i punës: Prezantimi i aktiviteteve të realizuara nga Zyrtarja për Barazi Gjinore/Koordinatorja, mbështetur në planet e punës.
2. Raportimi i anëtarëve/anëtareve: Prezantime të shkurtra mbi rastet e dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës në bazë gjinore, si dhe koordinimin ndërinstytucional.
3. Vlerësimi i nevojave dhe Plani i Punës: Prezantim nga Besarta Breznica, përfaqësuese nga Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK).
4. Planifikimi dhe Vendimmarrja: Koordinimi i aktiviteteve të ardhshme dhe marrja e vendimeve të nevojshme.
5. Rekomandime dhe mbyllja e takimit.

Pikat kryesore të takimit:

I. Raportimi i Zyrtares për Barazi Gjinore / Koordinatorës dhe anëtarëve

- U shqyrtuan rastet e dhunës në familje për periudhën e parë të vitit 2026.
- U diskutuan në mënyrë të detajuar dhe koordinimi institucional për trajtimin e tyre.
- U prezantua raporti i tremujorit të parë të mekanizmit.
- U konfirmua se Zyrtarja për Barazi Gjinore do të jetë koordinatore e mekanizmit, sipas vendimit të kryetarit të komunës.
- U raportua për përfundimin e 12 certifikimeve profesionale dhe aktiviteti për 8 Marsin.
- **Kërkesë:** Koordinatorja ka kërkuar nga anëtarët që brenda 7 ditëve të dërgojnë raportet e tyre 3-mujore përmes emailit.

II. Prezantimet dhe Statistikat nga Institucionet

Prezantime u mbajtën nga: Policia e Kosovës, Qendra e Shëndetit Mendor, Qendra për Punë Sociale (QPS), Mbrojtësi i Viktimave, Ndihma Juridike Falas, Strehimorja dhe Shërbimi Sprovues.

- **Ndihma Juridike Falas:** 9 raste të dhunës në familje.
- **Mbrojtja e Viktimave:** 19 kërkesa për urdhër mbrojtjeje dhe 4 raste me hallka.
- **Policia:** 63 raste (18 meshkuj, 21 të ndaluar, 22 me trajtim mjekësor).
- **Rekomandim:** U propozua angazhimi i një infermieri të forenzikës në QKMF.
- **Qendra për Aftësim Profesional:** Prezantoi punën e bërë përgjatë muajve.

III. Çështja e Strehimores

- Strehimorja nuk do të ketë kontratë/projekt me ministrinë nga fundi i prillit 2026. Projekti i ri është dorëzuar, por nuk pritet të zbatohet deri në korrik 2026.
- Gjatë kësaj periudhe stafi do të mbetet pa paga, ndërsa shpenzimet do të rimbursohen në mënyrë retroaktive.
- Për arsye sigurie, strehimorja ka vendosur të mos pranojë viktimë pa raport policor.
- Strehimorja do të kalojë nën menaxhimin e Ministrisë së Punës, Familjes dhe Vlerave të Luftës së Çlirimit.

IV. Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK)

- Prezantimi i projektit të ri për mbështetjen e punës së Mekanizmit dhe prezantimi i gjetjeve.
 - Do të ofrohet metodologji e re për punën e mekanizmit dhe raportimin.
-

Vendimet:

Të organizohen takime të ndara me:

1. Kryetarin e Gjykatës Themelore në Pejë.
 2. Kryeprokuroren e Prokurorisë Themelore (për shkak të mungesës së pjesëmarrjes në takimet e mekanizmit).
 3. Takim i përbashkët me Kryetarin e Komunës, Qendrën për Punë Sociale dhe Mbrojtësin e Viktimave.
-

Mbyllja e takimit: Takimi u përmbyll nga Zyrtarja për Barazi Gjinore në orën 12:15

Bashkëngjitur: Lista e pjesëmarrësve të nënshkruar gjatë takimit.
